

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe Rrustem Thaçi e Burim Shala anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) Sh.a. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari R.B., kundër të paditurit R.GJ. nga Gjakova rr. “...”, nr..., për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.133/11, të datës 05.06.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit R.GJ. nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.133/11, i datës 05.06.2014, **VËRTETOHET**, përveç pjesës për llogaritjen e kamatës së gjykuar, e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet ashtu që e njëjta llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 05.06.2014, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.133/11, të datës 05.06.2014, në pikën I të dispozitivit e ka hequr nga fuqia aktvendimin e gjykatës Ekz.749/10, të datës 02.06.2010 dhe i ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra në procedurën përmbarese. Në pikën II e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a në Prishtinë, ashtu që e ka detyruar të paditurin R.GJ. nga Gjakova, që paditëses së lartpërmendur t’ia paguaj shumën prej 57,53 €, me kamatë përkatëse ligjore, e cila paguhet në Bankat Komerciale në Kosovë për deponimet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë (12.04.2011), e tutje, e deri në pagim definitiv, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 20.00 €, e krejt këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit kërkesëpadia e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a, në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri R.GJ. nga Gjakova, t’ia paguaj edhe pjesën tjetër të mbetur të borxhit në lartësi prej 13,88 € me kamatë ligjore, e cila paguhet në Bankat Komerciale të Kosovës për deponimet e afatizuara të padisë në Gjykatë (12.04.2011), e tutje e deri në pagimin definitiv, është refuzuar si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, cenimit të dispozitave procedurale dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me

propozim që gjykata e shkallës së dytë në bazë të provave ekzistuese në lëndë dhe të dhënave të paditurit në këtë ankesë, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prishë si të kundërligjshëm e kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi apo lëndën të ia kthej të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 02.06.2010, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar propozim përmbarimi, në bazë të dokumentit të besueshëm (faturave), me arsye sikurse në propozim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditëses me datë 02.06.2010, ka nxjerrë aktvendimin Ekz.nr.749/10, me të cilën e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit t'i paguaj kreditorit shumën prej 71.41 € kamatë prej 3%

I padituri me datë 14.02.2011, ka parashtruar kundërshtim kundër aktvendimit mbi Ekzekutimin e Gjykatës Komonale në Gjakovë E.nr.749/10, të datës 02.06.2010, me propozim që aktvendimi i kundërshtuar të anulohet dhe kërkesëpadia e kreditorit të hedhet poshtë si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.133/11, të datës 05.06.2014, me të cilin e ka hequr nga fuqia aktvendimin e gjykatës Ekz.749/10, të datës 02.06.2010 dhe i ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra në procedurën përmbaruese duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga faturat të cilat ju referohen muajve 04.12.2009 dhe 01.03.2010, rezulton se i padituri për shërbime telefonike i ka borxh palës aktive në procedurën vlerën e kërkesëpadisë (shumën prej 71.41 €), mirëpo meqë i padituri në prapësimin e tij është thirrur në parashkrimin e kërkesës, gjykata e shkallës së parë konsideron se pretendimi i tij pjesërisht qëndron. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se kërkesa e paditësit është parashkruar sa i përket lartësisë prej 13.88 €, ndërsa i padituri është i obliguar që paditëses t'ia paguaj shumën prej 57.53 €, për të cilën lartësi nuk ekziston parashkrimi i kërkesës. Gjithashtu ka theksuar se pretendimet tjera të paditurit në prapësim se kinse i njëjti gjatë periudhës kohore lëndore nuk ka pasur sinjal të linjës telefonike nuk qëndrojnë pasi që nuk është argumentuar me prova dhe si i tillë është irelevant për vendosje ndryshe të çështjes ndërsa relevante është se ka pasur lëvizje impulsive në telefonin e shfrytëzuar.

Vendimin mbi shpenzimet e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së dhe suksesit në kontest ku palës paditëse në emër të shpenzimeve procedurale iu pranua shumata e përgjithshme prej 20.00 €, e cila i referohet taksave gjyqësore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa pretendimet tjera për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga ana e ankueses nuk janë paraqitur.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në arsyetim të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 8 dhe 423 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkruar faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 262 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të kësaj dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar e drejta materiale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveq për pjesën e llogaritjes së kohës së kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket kohës së fillimit të llogaritjes së saj, duke e gjykuar se e njëjta do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 05.06.2014, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4329/14, me datën 27.07.2018

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj